



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBETARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
ZYRA VENDORE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE SHIJAK

Nr 52 prot

Shijak më. 02.02.2026

NJOFTIM

PËR KUALIFIKIMIN E MËSUESVE PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 17 datë 22.07.2024, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve", ju bëjmë me dije se:

Mësuesi kandidat për provimet e kualifikimit, pas miratimit të kërkesës në SMIP për të marrë pjesë në procedurat e kualifikimit e dorëzon dosjen në ZVAP-në Shijak brenda datës 12 Shkurt 2026.

Provimi me shkrim, për kategorite e kualifikimit të mësuesvë në Sistemin Arsimor Parauniversitar, për vitin shkollorë 2025-2025, do të publikohet kalendari sipas profileve përkatëse Brenda datës 10 Mars 2025.

Orët e hapura për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025 do të zhvillohen gjatë periudhës Mars-Prill 2025.

Rezultatet e vleresimit të mësuesve për orët mesimore dhe për orën e prezantimit të projektit kurrikular të hapur për kategorinë mësuesi i kualifikuar dhe mësues specialist do të dorëzohen në ZVAP nga drejtuesi i institucionit arsimor brenda datës 30 prill 2026

KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE

1. Kandidati për kualifikim janë punonjësit Institucioneve Arsimore publike dhe private, të cilët kanë diplomë në fushën e mësuesisë ose zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barazvlefshme me to, të ngjashme ose të përafërta me fushën përkatëse të

dhënies në arsimin parauniversitar, si dhe kandidatët që japin lëndët e muzikës të pamore, kërcimit dhe edukimit fizik.

Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit, të cilët deri në datë 31 Dhjetor të vitit paraardhës, plotësojnë kushtet e mëposhtme për vjetërsinë e punës në arsim:

- Të paktën 3-5 vjet punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues i kualifikuar”.
 - Të paktën 8-10 vjet punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues Specialist” dhe të paktën 5 vjet punë pas marrjes së kategorisë “Mësues i Kualifikuar”.
 - Të paktën 15-20 vjet punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues Mjeshtër” dhe të paktën 7 vjet punë pas marrjes së kategorisë “Mësues Specialist”.
3. Punonjësit arsimor, të përmendur në pikën 2, që kanë mospërputhje midis vjetërsisë së punës në arsim dhe kategorisë së kualifikimit, kualifikohen për kategorinë më të ulët që nuk e kanë fituar ende.
- Duke filluar nga viti 2015-2016 e në vazhdim, mësuesit që plotësojnë kriteret e pikës 2 të këtij neni, kanë të drejtë të aplikojnë për të fituar kategorinë e kualifikimit nëse kanë kryer të paktën 3 ditë trajnimi të pasqyruara me 1 (një) kredit.

PORTOFOLI PERSONAL I KANDIDATIT

1. Dosja Profesionale e kandidatit përmban këto dokumenta:

- a)Diplomë:diplomë e ciklit të dytë master me 60-120 kredite (ECTS). Doktoratë të fituar në fushën e edukimit, drejtimit të arsimit dhe /ose që lidhet me profilin përkatës.
Diploma e ciklit të dytë nuk përfiton pikë nëse vlen si kriter arsimit për profesionin e mësuesit.
- b)Çertifikatat me kreditet përkatëse të vlefshme .
- c)Vlerësimi i fundit i drejtorit të institucionit arsimor (origjinale)
- ç)Gjuha e Huaj e mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, ose në provime ndërkombëtare, të njohuara sipas akteve ligjore në fuqi.
- d) Fotokopje e librezes së punës
- e) CV personale e kandidatit me fotografi
- ë) formular aplikimi

PERSONA BICENTRALE
10V
:TRIA E AR-AMITHE

Perkese me shkrim

Part pika 1.a,b.ç, d duhet te jene te njehsuar me originalin

**Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë postare në adresën: Zyra Vendore
Arsimore Parauniversitare Shijak, Adresa: Lagjia "Kodër", Shijak.
Bashkëlidhur formularin e aplikimit.**